

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

InfoSoft Office

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J62426002Q

NUIS/NIPT

Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

aarapi@infosoftoffice.al

E-mail

Administrator Frederik Prodani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/04/26

Data (viti/muaji/dita)

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-66452-04-19-2023

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

Bashkia Kavaje

---

Vlera e përlogaritur e prokurimit

*Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

4996800

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

Shërbime printimi dhe fotokopjimi

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2023/05/02

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

---

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Shërbime

2023/05/02

---

Numri i njoftimit

Kodi CPV

66452

79800000-2

---

Ankese mbi argument në KPP

---

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligjin për Prokurimin Publik, nr. 162 dt. 23.12.2020, në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### **3. Rrethanat dhe faktet**

*Përshkruani rrethanat e faktit.*

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kavaje, ka publikuar në faqen e APP-së në datë 20.04.2023, tenderin me objekt “Shërbime Printimi dhe fotokopjimi”, i cili parashikohet të zhvillohet me datë 02.05.2023, ora 0900.

Duke qene se disa prej ketyre kerkesave i gjykojme ne shkelje te LPP, Rregullave te Prokurimit Publik apo ne kundërshtim me specifikimet teknike te AKSHIT, po paraqesim kete ankese.

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

1. Tek Shtojca 5, Formulari I Specifikimeve teknike ne DST , AK ka kerkuar:

“Shërbimi dhe riparimi i fotokopjeve do te behet me pjese origjinale te prodhuesit”

Objekti i ketij prokurimi eshte “Shërbime Printimi dhe fotokopjimi”.

Ne kete objekt, perfshihet ndermjet te tjerave, furnizimi me konsumabla ( tonera, drum etj) , per te cilat AK ka kerkuar te jene pjese origjinale te prodhuesit.

Bazuar ne rregullat e prokurimit public ne LPP, rekomandimet e APP , vendimet e KPP, pas cdo kerkese te tille, duhet vendosur termi “ ose ekuivalent”: Kjo vlen per cdo procedure blerje dhe aq me teper, per procedura sherbimesh. Sherbimi I kerkuar, do te realizohet kryesisht me paisje te OE, te cilat do te mbeten te tij deri ne perfundim te kontrates dhe eshte pergjegjesi e tij , mbarevajtja e tyre. Nese tonerat etj, qe OE fitues perdor ne pajisjet e tij jane origjinale apo ekuivalente, kjo nuk sjell asnje ndikim ne punen e AK. Gjithashtu I njejt i impakt eshte per pajisjet qe zoteron AK, ku ne fund rendesi ka sherbimi cilesor dhe efektiv dhe qe nuk ndikohet ne asnje moment nga pjeset e kembimit apo tonerat qe perdor OE.

Pretendimet e mesiperme I bazojme ne :

Neni 36 “Specifikimet teknike” Nr.162/2020 Për Prokurimin Publik, qartazi percakton se: ç)Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njoftimi Nr.8297/3, date 23.01.2020 I APP, percakton se:

Gjithashtu, ne procedurat e prokurimit me objekt Blerje tonera , ne te cilat autoritetet kontraktore kerkojne qe tonerat te jene origjinale, duhet te perfshijne edhe fialet ose ekuivalent . Kerkesa per tonera origjinale pa perfshire termin ose ekuivalent , con vetem tek prodhuesit e pajisjeve. per te

cilat kerkohen tonerat, duke shmangur prodhues te tjere qe ofrojne tonera ekuivalente me originalet. Kjo me pas sjell si pasoje kufizim te piesemarrjes dhe konkurrences ne keto procedura prokurimi.

Gjithashtu KPP eshte shprehur ne menyre te vazhduar mbi pranimin e ekuivalences, konkretisht: Vendimin Nr. 124/2022 KPP:

“III2.8 KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 germa “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Referuar objektit dhe volumit të kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, thekson se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që të krijojë bindjen se operatorët ekonomikë kanë aftësi të ofrojnë produktet objekt-prokurimi, të nevojshme për zbatimin me sukses të kontratës, por gjithmonë duke përcaktuar kritere në përputhje me objektin e kontratës, në përpjesëtim me volumin e saj, si dhe jo kufizuese apo diskriminuese. Komisioni gjykon, se është e nevojshme që operatorët ekonomikë të ofrojnë produktet objekt-prokurimi por jo domosdoshmërisht në mënyrë kufizuese, pasi në fushën e veprimtarisë objekt-prokurimi, ekzistojnë edhe artikuj të tjerë ekuivalent, të cilët kanë funksionalitet të njëjtë. Gjithashtu, Komisioni gjykon, se edhe kërkesa për disponimin e artikujve me këto specifikime është e ekzagjeruar. Autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë specifikime teknike kufizuese e përjashtuese, me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar, ndaj çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti tij/saj.”. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të zbatojë me përpikëri dispozitën e mesiperme të LPP-se në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit duke shtuar termin ekuivalent për zërat e siperpermendur.”

Vendimi Nr.746 /2022, ku KPP shprehet:

Referuar sa më sipër, KPP e gjen të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik Infosoft Office ShPK për saktësimin e kriterit lidhur me termin origjinal ose ekuivalent dhe jo kompatibël sepse fakti që autoriteti kontraktor ka pranuar tonera ekuivalent do të thotë që në mënyrë indirekte ka pranuar dhe tonerat kompatibël. Në këtë kuptim KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për toner origjinal ose ekuivalent është vendosur në përputhje me përcaktimet ligjore të cilat detyrojnë autoritetin kontraktor të mos referojë drejt një prodhuesi ose një marke të caktuar, por fraza tonerat nuk duhet të jenë kompatibël krijon konfuzion në radhet e ofertuesve, pasi fraza ekuivalent e përfshin edhe termin kompatibël. Sa më sipër autoriteti kontraktor të modifikojë kriterin me sa më sipër.

Sa më lart, kërkojmë modifikim e ketij specifikimi ne:

Shërbimi dhe riparimi i fotokopjeve, printerave do të bëhet me pjesë origjinale/ekuivalente të prodhuesit.

2. Te shtojca 8, Kriteret e vecanta te kualifikimit ne DST, AK ka kerkuar ne kriterin 2.3.2:

“2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune për 1 (një) specialist për riparimin e pajisjeve Ricoh, i cili duhet të jetë i pajisur me dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi të lëshuara nga prodhuesi i markës objekt shërbimi apo nga akademi/shkolla profesionale/distributore të autorizuar.

3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune për 1 (një) specialist për riparimin e pajisjeve Xerox, i cili duhet të jetë i pajisur me dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi të lëshuara nga prodhuesi i markës objekt shërbimi apo nga akademi/shkolla profesionale/distributore të autorizuar.

4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune për 1 (një) specialist për riparimin e pajisjeve të cilat do të ketë vetë operatori ekonomik (sic kërkohet në shtojcën 5, paragrafi i dytë) , i cili duhet të jetë i pajisur me dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi të lëshuara nga prodhuesi i markës objekt shërbimi apo nga akademi/shkolla profesionale/distributore të autorizuar..

Kërkesat e pikave 2, 3 dhe 4 mund të plotësohen edhe nga i njëjti person.”

AK argumenton kriterin 2.3.2, si me poshte:

“ Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë aftësitë teknike dhe profesionale, garantojnë se zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Duke qene se mirembajtja e marka te ndryshme te pajisjeve objekt i shërbimit është specifike kërkohet që operatorët ekonomikë të kenë staf të specializuar të certifikuar specifikisht për pajisjet në fjalë. Kjo nisur dhe nga përvoja e mëparshme, vështiresitë dhe mosëficientia e riparimit të pajisjeve nga specialiste jo të profilizuar specifikisht për mirembajtjen e pajisjeve të markave të caktuara”.

Veme re një kontradiktë midis kërkesave në kriterin 2.3.2 në DST , dhe argumentimit të tyre në PV e argumentimit.

Në kriterin pranohet një punonjes me kontratë të vlefshme, i cili të jetë i pajisur : ose me

dëshmi të kualifikimit profesional, ose me diploma ose me certifikata trajnimi, të lëshuara këtu : ose nga prodhuesi i markës objekt shërbimi ose nga akademi ose nga shkolla profesionale ose nga distributor të autorizuar.

Nderkohe që në PV e argumentimit, AK është shprehur se stafi i specializuar, duhet të jetë i certifikuar , specifikisht për pajisjet në fjalë.

Në këto kushte, kërkojmë që AK të modifikojë PV e argumentimit, për kriterin e mësipërm, në mënyrë që të mos ketë vend për interpretime të procesit të vlerësimit të ofertave. Ky PV, përveç është në kundërshtim me kriteret e kualifikimit në DST e hartuar prej vetë AK, është edhe në kundërshtim me LPP, rregulloren e prokurimit publik dhe vetë vendimet e KPP për raste ekuivalente.

AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar minimalisht 3 Inxhinierë IT ose Elektronik për mirëmbajtjen e pajisjeve. Këta punonjes kanë përfunduar studimet e larta, janë diplomuar si inxhinierë të fushës, janë me shumë se të aftë të mirëmbajnë të gjitha pajisjet. Kërkesa që të jenë edhe të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve, në mënyrë direkte apo indirekte, është e ekzagjeruar dhe tejkalon synimin për të cilin është vendosur.

Në argumentin e dhënë nga AK argumentohet qartë nevojja e AK për persona të aftë për të kryer mirëmbajtjen e pajisjeve dhe garantimin e një shërbimi cilësor, duke marrë parasysh dhe përvojat e mëparshme, vështiresitë dhe mosëficientia e riparimit të pajisjeve nga specialist jo të profilizuar, por mungojnë argumentat për vetëm 2 specialistet e certifikuar nga prodhues apo akademi/shkolla profesionale/distributore të autorizuar të pajisjeve, mund të mundesojnë dëkë të tillë?!

Kërkesa që 3 Inxhinierë IT ose elektronik dhe specialiste, të kenë edhe certifikime shtesë nga prodhues apo akademi/shkolla profesionale/distributore të autorizuar të pajisjeve përkatëse, nuk është proporcionale me objektin e kontratës. Ky kriter në gjykimin tonë është jo proporcional me objektin dhe vështirësinë e procedurës së prokurimit dhe për të vërtetuar këtë, aplikojmë testin e proporcionalitetit i cili parashikon kushtet dhe kriteret që një normë të jetë proporcionale’.

‘Pra duke iu referuar kriterit të vendosur dhe duke aplikuar testin e proporcionalitetit, nëse kriteri është:

1. I përshtatshëm për arritjen e objektivit pra të zbatimit të kontratës në mënyrë sa më optimale
2. I domosdoshëm, pra AK nuk kishte asnjë mundësi tjetër përveçse të vendoste këtë kriter
3. Dhe kriteri është proporcional, në kuptim të përshtatshmërisë së kriterit me situatën reale, pra

duke marrë parasysh kriterin e vendosur dhe aftësinë teknike e zbatuese të operatorëve ekonomike në treg për të garantuar konkurrencë të lirë në procedurat e prokurimit publik’.

‘Kriteri nuk është proporcional sepse, instalimin, konfigurimin, vënien në punë, mirëmbajtjen e pajisjeve të printimit Xerox/Ricoh mund ta bëjë cdo teknik elektronik/mekanik i certifikuar për pajisje printimit të cdo lloj modeli. Kriteri nuk është proporcional sepse AK ka mundësi të vendose teknike Elektronikë/Mekanik për të zbatuar në mënyrë optimale kushtet e kontratës, pra kërkesa e pikës 2.3.2 duhet modifikuar ose të hiqet.

Per me teper AK e kufizon ekuivalencen e certifikimeve të teknikeve nga ana e prodhuesit Xerox, Ricoh në certifikim të teknikeve në akademi/shkolla profesionale/distributore të autorizuar të Xerox dhe Ricoh. Alternativat si Akademi/shkolla profesionale/ distributor të autorizuar të cojnë drejt një fjale të vetme që është distributor i autorizuar. Asnjë Prodhues (Manufacturer) në industrinë e printimit nuk e delegon apo autorizon certifikimin e specialisteve në akademi/shkolla.

Automatizimi krahas prodhuesit të pajisjes të gjithë opsionet e tjera për certifikimin e këtyre specialisteve për mirëmbajtjen e pajisjeve Ricoh dhe Xerox të cojnë drejt varesisë nga prodhuesi apo distributor i autorizuar i këtyre markave.

Per me teper që autorizimin për shërbim mirëmbajtje Xerox dhe Ricoh, në vendin tonë I disponojnë vetëm 2 kompani ose më së shumti të dyja bashkë I zoteron vetëm një kompani e vetme. Vendosja e kriterëve të tilla jo vetëm që nuk arsyetohet nevojat teknike të institucionit por në mënyrë direkte krijon monopol duke paracaktuar fituesin.

Në mbështetje të argumentave të dhëna më lart bazohemi dhe në Vendimin Numer 06/2023 të Komisionit të Prokurimit Publik I cili I jep të drejtë OE Rikon-AI për heqjen e certifikimeve të prodhuesit dhe distributorit të autorizuar për pajisjet që disponon AK ( Lexmark, Xerox ), si më poshtë:

“III.2.5. Për sa më sipër, KPP nisur nga parashtrimet e operatorit ekonomik ankimues, si në ankese, gjykon se autoriteti kontraktor, të gjitha parashtrimet e paraqitura nga autoriteti kontraktor në lidhje me këtë pretendim, referuar procesverbalit, ky i fundit në asnjë rast nuk ka mirëargumentuar pse është pikërisht paraqitja e autorizimit të prodhuesit/distributorit të autorizuar për kriteret e mësipërme, dokumenti i cili i jep garancinë e vetme për sigurimin e produktit të kërkuar në kohë dhe cilësi dhe se kjo nuk mund të realizohet nga dokumente të tjera të cilat autoriteti kontraktor ka kërkuar në kriteret kualifikuese apo në specifikimet teknike. Nga verifikimi i dokumenteve të tenderit të hartuara nga autoriteti kontraktor, KPP gjykon, se informacionin në lidhje me cilësinë e artikujve dhe mundësinë e sigurimit të tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, autoriteti kontraktor e siguron edhe përmes përmbushjes nga operatori ekonomik ankimues të kriterit për paraqitjen e katalogut, ku përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull, sipas kriterit të përcaktuar nga autoriteti “Për këtë operatori duhet të paraqesë katalog ose broshurë” . Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kërkesat e autoritetit kontraktor se: 2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues, për pajisjet që disponon Autoriteti Kontraktues (Lexmark, Xerox), duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose distributori zyrtar për mallrat objekt prokurimi, kjo e vertetuar nepermjet dokumentave origjinal si përfaqësues i 15 kompanise prodhuese. Në rast paraqitje Autorizimi Distributori, OE duhet të paraqesë një leter angazhim ose Akt marreveshje midis kompanise prodhuese dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të kompanise/distributorit si: telefon/fax/e-mail/ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. 2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues, për pajisjet që do të ofertoje, duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose distributori zyrtar për mallrat objekt prokurimi, kjo e vertetuar nepermjet dokumenteve origjinal si përfaqësues i kompanise prodhuese. Në rast paraqitje Autorizimi Distributori, OE duhet të paraqesë një leter angazhim ose Akt marreveshje midis kompanise prodhuese dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të kompanise /distributorit si: telefon/ fax/ e-mail/ ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. 2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues, për softëra që do të ofertoje, duhet të paraqesë autorizim

nga kompania prodhuese ose distributori zyrtar per mallrat objekt prokurimi, kjo e vertetuar nepermjet dokumentave orgjinal si perfaqesues i kompanise prodhuese. Ne rast paraqitje Autorizimi Distributori, OE duhet te paraqese nje leter angazhim ose Akt marreveshje midis kompanise prodhuese dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te kompanise /distributorit si: telefon/ fax/ e-mail/  ebsite kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi. T  gjitha dokumentet duhet t  jen  origjinale ose kopje t  noterizuara. Rastet e mosparaqitjes s  n j dokumenti, ose dokumente false dhe t  pasakta, konsiderohen kushte p r skualifikim. Jan  k rkesa t  ekzagjeruara dhe n  kund rshtim me q llimin e lex specialis, si dhe rregullat e prokurimit publik t  cilat kan  si synim nxitjen e konkurrenc s dhe sigurimin e n j trajtimi t  barabart  dhe jodiskriminues p r t  gjith  operator t ekonomik  pjes marr s n  procedurat e prokurimit, prandaj autoriteti kontraktor duhet t  marr  masa p r heqjen e k tij kriteri p r kualifikim nga dokumentet e tenderit t  procedur s s  prokurimit objekt-ankimi. Sa m  sip r, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues q ndron.”

Kjo vlen edhe per piken numer 4 si me lart ku kerkohet nje specialist I certifikuar nga prodhuesi ose Akademi/shkolla profesionale/ distributor te autorizuar per pajisjet qe vete OE do te ofroje. Ne mbeshtetje te ketij argumenti qendron vendimi Numer 412/2022 ku Komisioni I Prokurimit Publik I jep te drejte OE Infosoft Office per heqjen e kriterit “Stafi teknik te (pakten 3 inxhiniere) duhet t  jet  i certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve qe posedon p r mirembajtjen e pajisjeve ose ekuivalente.”

Per keto arsye kerkojme te hiqen kerkesat e meposhtme per kualifikim, te cilat ne teresine e tyre, kerkojne patjeter lidhje te OE me prodhuesin e paisjes ose me distributorin e autorizuar, duke kufizuar konkurencen dhe paracaktuar fituesin.

? Operator t ekonomik  duhet t  paraqesin pran  Autoritetit Kontraktor kontrat  t  vlefshme pune p r 1 (n j) specialist p r riparimin e pajisjeve Ricoh, i cili duhet t  jet  i pajisur me d shmi t  kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi t  l shuara nga prodhuesi i mark s objekt sh rbimi apo nga akademi/shkolla profesionale/distributore te autorizuar.

? Operator t ekonomik  duhet t  paraqesin pran  Autoritetit Kontraktor kontrat  t  vlefshme pune p r 1 (n j) specialist p r riparimin e pajisjeve Xerox, i cili duhet t  jet  i pajisur me d shmi t  kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi t  l shuara nga prodhuesi i mark s objekt sh rbimi apo nga akademi/shkolla profesionale/distributore te autorizuar.

? Operator t ekonomik  duhet t  paraqesin pran  Autoritetit Kontraktor kontrat  t  vlefshme pune p r 1 (n j) specialist p r riparimin e pajisjeve tw cilat do t  ket  vet  operatori ekonomik (sic k rket n  shtojc n 5, paragrafi i dyt ) , i cili duhet t  jet  i pajisur me d shmi t  kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi t  l shuara nga prodhuesi i mark s objekt sh rbimi apo nga akademi/shkolla profesionale/distributore te autorizuar.

3. Se fundmi gjate shqyrtimit te DST, ne shtojcen 5 “specifikimet teknike” ne DST, AK eshte shprehur:

“Lista e printerave q  ka Autoriteti Kontraktor dhe q  duhet t  mir mbahen nga kontraktuesi gjat  gjith  afatit t  kontrat s s  sh rbimit: ? RICOH – (MP 201, MP 2550, MP 161, MP C2551, MPC 3300) ? Xerox Versalink C7025, Xerox Workcentre 5230 , Xerox Workcentre 5225, Xerox Phaser 3250, Xerox Workcentre 7125. P r t  realizuar sistemin e menaxhimit t  sh rbimit t  printimit/fotokopjimit/skanimit, p rvec pajisjeve q  disponon vet  Autoriteti Kontraktor sipas list s m sip r.”

Ju lutemi saktsoni numrin e pajisjeve sipas modelit qe dispononi ne menyre qe te mos hasim problematika gjate ofertimit.



**5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme**

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)*

---

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

nuk ka

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

nuk ka

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

aarapi@infosoftoffice.al

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Frederik Prodani